

VENDIM
Nr.87, datë 10.11.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË HIDROINVEST 1 SHPK ME SERI PV08K,
NR.66, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.113,
DATË 24.9.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 pika 4 germa “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “HIDROINVEST 1” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.66, seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për ndryshimin e licencës me numër nr.66, seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008, të mbajtur nga shoqëria “HIDROINVEST 1” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta